

LIGJ
Nr. 122/2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8/1 “Të ardhura të përjashtuara”, pas pikës 8 shtohen pikat 9 e 10 me këtë përmbajtje:
“9. Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore.
10. Të ardhurat e përfituara nga institucionet shtetërore për arritjet në shkencë, sport, kulturë.”.

Neni 2

Në nenin 13/2 pika 1, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:
“gj) Për të vetëpunësuarit, të cilët kanë një qarkullim nën 2 (dy) milionë lekë, si e ardhur bruto konsiderohet vlera 10 për qind e të ardhurave vjetore bruto nga zhvillimi i aktivitetit ekonomik/tregtar apo shërbime.”.

Neni 3

Në fund të nenit 20 “Shpenzime të njohura” shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:
“Bursat që u jepen nxënësve dhe studentëve nga institucionet arsimore, publike dhe jopublike, njihen si shpenzim i zbritshëm deri në masën e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me kusht që institucionet arsimore publike dhe jopublike, në fillim të vitit shkollor, të paraqesin pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës numrin dhe shumën e bursave.”.

Neni 4

Në nenin 27 “Mbartja e humbjeve”, në pikën 2 fjalët “ndryshon me më shumë se 25 për qind” zëvendësohen me fjalët “ndryshon me më shumë se 50 për qind”.

Neni 5

Në nenin 38 “Dispozitat kalimtare”, në pikën 7, në fund të paragrafit të tretë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Ndaj individëve, të parashikuar në këtë ligj, të cilët kanë bërë ose bëjnë deklarinimin e të ardhurave personale për vitin fiskal 2011, pas datës 30 shtator 2012, nuk aplikohen gjobat për mosdeklarim në afat, për deklarimet e bëra deri në datën 31 dhjetor 2012.”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.12.2012

Shpallur me dekretin nr.7911, datë 7.1.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani